



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.97/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Socijaldemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, paraqitur kundër Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.97/2025, e datës 02.10.2025, e paraqitur nga subjekti politik Socijaldemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, kundër Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Socijaldemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, ku pretendohet se kandidati Arhim Ajazi (numri rendor 2), në profilin e tij në Facebook ka publikuar një spot promovues në të cilin janë filmuar fëmijë të mitur dhe janë përdorur për qëllime politike gjatë fushatës zgjedhore. Konsideroj se me këtë veprim është kryer shfrytëzim i personave të mitur në fushatë, dhe është shkelur Kodi i Sjelljes së subjekteve politike, simpatizuesve dhe kandidatëve të tyre, si dhe është cenuar integriteti dhe rrjedha e ndershme e fushatës zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si prove fotografi nga rrjeti social Facebook,.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik NDS theksohet se publikimi i videos së kontestuar ka ndodhur më 30.09.2025 në orën 9:56. Kjo mund të verifikohet nga screenshot-et, fotografitë e ekranit dhe lidhjet për atë publikim - <https://www.facebook.com/share/v/1K5btvka7K/>, dhe ankesa është marrë nga PZAP-i, më 02.10.2025 në orën 13:47. Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur pas 52 orësh nga momenti kur video-spoti u postua dhe u bë i disponueshëm për publikun. Sipas Rregullores nr. 01/2025 (PZAP) për procedurën e paraqitjes së ankesave dhe

vendimmarrjes, rregullave dhe procedurave në fuqi, neni 9, paragrafi 5. dhe në lidhje me nën-paragrafin 5.5, një ankesë mund të paraqitet më së voni brenda 48 orëve nga momenti i marrjes vesh ose i disponueshmërisë së përmbytjes së diskutueshme. Në këtë rast, është e qartë se ankesa është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor prej 48 orësh, sepse kishin kaluar më shumë se 52 orë, theksohet në përgjigje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

- Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Socijaldemokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, të paraqitur kundër Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj”,* si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”,* nën paragrafi 3.2. *“nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”,* ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: *“për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”.*

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi përveç linkut të bashkangjitur nuk është specifikuar data e publikimit të postimit në rrjetin social Facebook të kandidatit ndaj të cilit është ushtruar ankesa, meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të spotit , Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.”* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pasafatshme, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se kandidati Arhim Ajazi (numri rendor 2), në profilin e tij në Facebook ka publikuar një spot promovues me datë 30 Shtator në ora 09:56, ndërsa ankesa nga pala ankuese SDU, është parashtruar me datë 02.10.2025 në ora 13:47.

Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesa është parashtruar, pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga pala ankuese lidhur me ankesën, përkatësisht ankesën ZL.Anr.97/2025 shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 30.09.2025 në orën 09:56, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 02.10.2025, në ora 13:47, që do të thotë se e ankesa në fjalë është paraqitur pas afatit ligjor, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh.

Paneli ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, dhe nenet 9 paragrafi 5 dhe 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.97/2025 datë 03.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi